



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT
NJËSIA E PROKURIMIT

Nr. ____ Prot.

Berat, me ____/____/ 2023

PROCESVERBAL - Tipi i kontratës - PUNË

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

OBJEKTI I PROKURIMIT : “ Ndertim i tregut te gjelber Berat(Green Market)»

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV) : 45000000-7__pune ndertimi

VLERA E FONDIT LIMIT : 25 292 738 (Njëzet e pesë milion e dyqind e nëntëdhjetë e dy mijë e shtatëqind e tridhjetë e tetë) lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti kontraktor Bashkia Berat (Njësia e Prokurimit), ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë :

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë :

- a. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;
- b. Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë :

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar :

2.2.1 Për të provuar kapacitetet ekonomike dhe financiare, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2020, 2021 dhe 2022, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e parashikuar e kontratës që po prokurohet.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë :

Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vertetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2020, 2021 dhe 2022, të paraqitura në organet tatimore dhe të konfirmuara nga ana e këtyre organeve. Kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse bilancet janë në përputhje me parashikimet e nenit 43/4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 të ndryshuar.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit në raport me përqindjen që ka në këtë bashkim operatorësh

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

*Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat". i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare. Ndërsa shoqërimi me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, behet duke iu referuar parashikimit në nenin 41 shkronja c" të Ligjit nr. 1009/2009: "Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga ekspertë kontabel ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabel, për dy vite radhazi, tejkalojnë **dy prej tre treguesve të mëposhtëm** : i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabel përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh, ii) shumën e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabel arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh, iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabel".*

2.3 Aftesite Teknike dhe profesionale:

2.3.1 Përvojë të suksesshme në realizimin e të paktën:

- a. punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet (pa TVSH) dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

ose

- b. punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet (pa TVSH).

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e ben oferten të kualifikueshme.

Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit/ve Ekonomik do të kryhet bazuar në dokumentat e mëposhtme:

i) Për kontrata të realizuara me ente publike, operatori/et ekonomik, duhet të paraqes/in dokumentacionin e mëposhtëm, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përbushjen e suksesshme të punëve:

1. Formular vleresimi per realizimin e punimeve sipas shtojcës nr.9, shoqëruar me;
2. Kontratën/at e Sipërmarrjes;
3. Situacionin përfundimtar të objektit;

Formulari i vlerësimit duhet të përcaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve, faktin nëse kontrata është realizuar me sukses, përqindjen e punimeve në rast bashkimi të shoqërive, etj.

ii) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori/et ekonomik duhet të paraqes/in dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Kontratën/at e Sipërmarrjes;
2. Situacionin përfundimtar të objektit;
3. Fatura tatimore përfundimtare.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në një vlerë jo më të vogël se 50 % të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose sa dyfishi i vlerës së fondit limit, për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

2.3.2 Liçensa profesionale lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës.

2.3.2/a Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturas dhe Energjise, në bazë të VKM nr. 42 datë 16.01.2008, të ndryshuar, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme :

Për punimet e përgjithshme të ndërtimit:

- **N.P - 1 A** (Punime germimi në tokë)
- **N.P - 4 A** (Rruge, autostrada, mbikalime, hekurudha, linja tramvai, metro, pista aeroportuale)
- **N.P - 9 A** (Punime dhe mbrojtje lumore sisteme hidraulike dhe bonifikime)

Për punimet speciale të ndërtimit:

- **N.S - 6 A** (Sinjalistika rrugore jo ndricuese)
- **N.S - 8 A** (Ndërtime parafabrikat me beton të armuar, struktura metalike dhe druri)
- **N.S - 18 A** (Punime topogjeodezike)

Shënim: Operatorët e huaj duhet të kenë kryer ekuivalentimin (njehsimin) e liçencave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë institucionit përkatës siç përcaktohet në “Rregulloren për kriteret dhe procedurat e dhënies së

liçencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi” e miratuar me VKM – në Nr. 42, datë 16.01.2008 ”Për miratimin e Rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”. Mos paraqitja në këtë formë është kusht s’kualifikues.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, si dhe VKM – së Nr. 42, datë 16.01.2008 ”Për miratimin e Rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”. Të dhënat për liçencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, ligjit Nr. 8402, datë 10.09.1998 ”Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, ku neni 8 përcakton ”Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj të pajisur me liçencën përkatëse për zbatim punimesh ndërtimore. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit në përputhje me projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standartet kombëtare ose europiane.

-Operatorët ekonomikë duhet të paraqesë liçencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, sipas formatit të miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 42 date 16.01.2008, ”Per miratimin e rregullores per kriteret dhe Procedurat e dhenies se licencave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te Subjekteve juridike qe ushtrojne veprimtari ndertimi”. Shqyrtimi i licencave do të bëhet mbi bazën e rregullave të parashikuara sa me sipër. Licenca profesionale e Operatorit Ekonomik lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës

Licencat për punimet e përgjithshme të ndërtimit dhe punimet speciale të ndërtimit janë kërkuar bazuar në zërat e punimeve të preventivit, referuar vlerave të preventivuara për këtë kategori licence.

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë :

Kategoria e kërkuar	Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive	Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse
N.P - 1	Punime germimi ne toke	Ne kete kategori perfshihet A/1 Germim dheu per lirim dhe	A (0- 20 milionë lekë)	Brenda vlerës së kufirit të parashikuar në VKM Nr. 42 date 16.01.2008, i ndryshuar
N.P - 4	Rruge,autostrada,mbikalime, hekurudha,linja tramvai,metro,pista aeroportuale	Ne kete kategori perfshihet A/2/3/4/5/6/7	A (0- 20 milionë lekë)	Brenda vlerës së kufirit të parashikuar në VKM Nr. 42 date 16.01.2008, i ndryshuar

N.P - 9	Punime dhe mbrojtje lumore sistemime hidraulike dhe bonifikime	Ne kete kategori , ne preventiv perfshihet grup zeri E-Ndertimi i Argjinatures	A (0- 20 milionë lekë)	Brenda vlerës së kufirit të parashikuar në VKM Nr. 42 date 16.01.2008, i ndryshuar
N.S - 6	Sinjalistika rrugore jo ndricuese	Ne kete kategori , ne preventiv perfshihet grup zeri G-Sinjalizimet dhe siguria rrugore	A (0- 20 milionë lekë)	Brenda vlerës së kufirit të parashikuar në VKM Nr. 42 date 16.01.2008, i ndryshuar
N.S - 8	Ndërtime parafabrikat me beton të armuar, struktura metalike dhe druri	Kjo kategori licence i referohet zërave të punimeve të parashikuara në preventin e punimeve, konkretisht D/1, D/3	A (0- 20 milionë lekë)	Brenda vlerës së kufirit të parashikuar në VKM Nr. 42 date 16.01.2008, i ndryshuar
N.S - 18	Punime topogjeodezike	Lidhet me piktimin e objektit, kuotat per sitemimin e sheshit etj.	A (0- 20 milionë lekë)	Brenda vlerës së kufirit të parashikuar në VKM Nr. 42 date 16.01.2008, i ndryshuar

2.3.2/b Operatori ekonomikë pjesemarrës duhet të jete i pajisur me license leshuar nga QKL “ Për grumbullim, ruajtje dhe transportin e mbetjeve te ngurta “Kodi III. 2.B ” (Për grumbullim, ruajtje dhe transportin e mbetjeve te ngurta), së bashku me aktin e miratimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 39, pika 6/a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, si dhe në nenin 4, pika e 1/b e ligjit nr. 10448, datë 14.7.2011 “Për lejet e mjedisit” i ndryshuar, ku parashikohet se: “leja e mjedisit e tipit B është e detyrueshme për kryerjen e veprimtarive të kategorisë B, lista dhe pragjet përkatëse të të cilave janë përcaktuar në shtojcën I/B të këtij ligji”.

Në shtojcën I/B është listuar edhe veprimtaria “Menaxhimi i mbetjeve”.

Në nenin 57/2 të ligjit nr. 10463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar, parashikohet se: ‘Qendra Kombëtare e Licencimit lëshon **licencën për transportin e mbetjeve**, e cila përfshihet në nënkategorinë III. 2.B të fushës III të vendimit nr. 538, datë 26.5. 2009 të Këshillit të Ministrave “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga/apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, pas miratimit të saj nga ministri”.

Ndërkohë, sipas VKM nr. 538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet qendrës kombëtare të licencimit (qkl) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta” : “ Veprimtaria e nënkategorisë III. 2. B specifikohet në veprimtari të tilla si grumbullim, transportim, ruajtje, riciklim, përpunim apo asgjësim i mbetjeve të llojeve të ndryshme”.

Kjo kategori licence i referohet zërave të punimeve të parashikuara në preventivin e punimeve objekt prokurimi (A Punime per lirim dhe pastrimin e sheshit).

2.3.3 Dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik :

- a. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë **personelin kryesor, drejtues teknik** në licencën e shoqërisë, si më poshtë:
- Inxhinier Ndertimi 1 (nje)
 - Inxhinier Hidroteknik 1 (nje)
 - Inxhinier Gjeodet 1 (nje)

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatori ekonomik per secilin pjesetar te stafit teknik duhet te paraqese: Kontratë pune, Diplomë Universitare.

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të bëjë verifikime lidhur me deklarin e OE, në funksion të përmbushjes së këtij kriteri.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi : Kërkesat e shkronjave a) dhe b), të pikes 2.3.3, të kriterëve të vecanta për kualifikim, janë bazuar në piken 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/c), te VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, te ndryshuar dhe VKM nr. 514, datë 20.9.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP)”, të rishikuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Personeli i mesiperm kerkohet ne baze te vleresimit te preventivit dhe grafikut te punimeve

- **Inxhinieri i Ndërtimit** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet për secilin nga zërat e punimeve ndërtimore, referuar punimeve te parashikuara në preventivin A “Punime per lirim dhe pastrimin e sheshit”, B “Punime per ndertimin e rruges”, 3 Punime tratuari".
- **Inxhinieri Hidroteknik** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve per ndertimin e argjinatures.
- **Inxhinieri Topograf/Gjeodet/Markshajder** është përgjegjës për zbatimin e sakte të kuotave të projektit objekt prokurimi për realizimin e saktë të kuotave të themeleve, kuotave të shtresave etj.

2.3.4 Operatorët ekonomikë duhet të disponojnë punonjës të specializuar/të kualifikuar, si më poshtë :

- | | |
|-------------------|----------|
| - Teknik Ndertimi | 2 (dy) |
| - Karpentier | 2 (dy) |
| - Hidraulik | 2 (dy) |
| - Murator | 5 (pese) |
| - Hekurkthyes | 2 (dy) |

Për punonjësit e kualifikuar si më sipër, ofertuesi duhet të paraqesë :

- kontratën individuale të punës;
- Certifikata/diploma për formimin profesional (të vlefshme), të cilat duhet të jenë të lëshuara nga institucione publike/private të licensuara sipas ligjit Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në R.Sh.”, i ndryshuar si edhe të figurojnë në listepagesat e shoqërisë për muajin Shtator 2023.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi : Kërkesat e mesiperme, germa b) janë bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, të ligjit nr. 15/2017 “Per arsimin dhe formimin profesional në R.Sh.” dhe VKM nr. 514, datë 20.9.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP)”, të rishikuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

-Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, relacionin teknik dhe zërat e punimeve,

Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Numri i stafit kryesor inxhinieri nderimi, është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës së kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratës.

Hartimi i këtyre kriterëve është vendosur edhe mbi bazën e parashikimeve të VKM Nr.42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar., sipas të cilës, “Drejtues teknik”-individit/ët e diplomuar në degët përkatëse të universitetit që janë është/janë përgjegjës/a për ndërtimin e objekteve sipas projektit dhe në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës. Gjithashtu, hartimi i kriterëve për personelin kryesor si dhe punonjës të specializuar/të kualifikuar është hartuar në përputhje me nenin 39/6/c/ç të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku parashikohet se: ”Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: c) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose ç) fuqinë minimale punëtore të operatorit ekonomik, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit”.

Konkretisht: Janë kërkuar diplomat gjithashtu edhe licencat personale për të parë nëse stafi ka , aftësinë dha ka përputhshmëri me legjislacionin për të përmbushur sa më mirë punët e kërkuara sipas specifikimeve teknike.

(Shënim- argumentoni nevojën për stafin e kërkuar, duke specifikuar punimet apo veprimtaritë konkrete për të cilat kërkohet ekspertiza e tyre profesionale, argumentimin mbi kërkesat dokumentare për disponimin e këtij stafi, si dhe për llojin e licencës/certifikatës/kualifikimit të kërkuar për secilin prej tyre, nëse është rasti, duke specifikuar edhe aktin ligjor apo nënligjor konkret, ku parashikohet nevoja për licencimin apo certifikimin e tyre).

Personeli i mësipërm kërkohet në bazë të vlerësimit të preventivit dhe të grafikut të punimeve.

- **Tekniket e ndërtimit** janë te nevojshem për ndjekjen e realizimit të punimeve të ndërtimit, sipas zërave të preventivit të punimeve.
- **Hidrauliket** janë te nevojshem për ndjekjen dhe realizimin e punimeve hidraulike, sipas zërave të preventivit të punimeve, nën mbikëqyrjen e inxhinierit.
- **Hekurkthyesit** janë te nevojshem për realizimin e punimeve të hekurit, referuar zërave të preventivit të punimeve, nën mbikëqyrjen e inxhinierit.
- **Murator** është i nevojshem për realizimin e punimeve të muratures, sipas zërave të preventivit të punimeve, nën mbikëqyrjen e inxhinierit.
- **Karpentieret** janë te nevojshem për prerjen dhe montimin e strukturave prej druri si dhe ndërtimin e kornizave dhe strukturave të tjera përforcuese prej druri apo materiale të tjera, të nevojshme për realizimin e objektit që do të ndërtohet, nën mbikëqyrjen e inxhinierit.

2.3.5 Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se kanë të punësuar në stafin e tyre I (një) punonjës i cili të plotësojë kërkesat dhe të disponojë certifikatën si “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë”, në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr. 10237 date 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M Nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier".

Për këtë operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

- kontratën e punës,
- diplomën/certifikatën përkatëse.

Shënim. Kjo kerkese permbushet nepermjet plotesimit dhe paraqitjes nga operatoret ekonomike te formularit permbledhes te vetedeklarimit, sipas shtojces 8 te DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi : Kërkesa e shkronjës d) të pikës 2.3.3, të kriterëve të vecanta për kualifikim, është bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të I igjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht :

Kërkesa e mësipërme mbështetet në ligjin nr. 10327 datë 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M nr. 312. datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”. Natyra e kontratës dhe specifikat e saj kërkojnë njohuri e përgatitje të posacme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur ceshtje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM nr.

312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ofrojë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Cdo punëdhënësi zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmë e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes.

Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të dëshmojnë se kanë të punësuar në stafin e shoqërisë punonjës të kualifikuar, të pajistur me Dëshmi të Aftësisë Profesionale (DAP), lëshuar nga D.P.SH.T.RR., minimalisht si më poshtë :

Manovrator 5 (pese)

Shoferi 5 (pese)

(Në rastet kur mjetet/makinertë disponohen me qera, këta punonjës mund të jenë të kontraktuar).

Për këtë operatorët ekonomikë duhet të paraqesin :

- Kontratat e punës të vlefshme;
- Dokument (dëshmi kualifikimi profesional), që të vërtetojë kualifikimin profesional të kërkuar, referuar rregullores “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e Dëshmisë së Aftësisë Profesionale për përdoruesit e makinertë të rënda për punime ndërtim dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të tyre”, miratuar me urdhërin nr. 200, datë 16.5.2019, të Ministrisë të Infrastrukturës dhe Energjitikës.

Shenim. Kjo kërkesë përmbushet nepermjet plotesimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetedeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevojë për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës, si dhe bazuar në rregulloren “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e Dëshmisë së Aftësisë Profesionale për përdoruesit e makinertë të rënda për punime ndërtim dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të tyre”, miratuar me urdhërin nr. 200, datë 16.5.2019, të Ministrisë të Infrastrukturës dhe Energjitikës.

2.3.6 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej minimalisht 27 (njetete e shtate) punonjës. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetedeklarimit.

Ndërsa ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, duhet të dorëzojë pranë autoritetit kontraktor përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevojë për tu kërkuar sqarime nga AK, dokumentacionin si më poshtë:

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet Shoqërore ose Administrata Tatimore sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj, për periudhën Shtator 2023.
- Listëpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën Shtator 2023.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit sipas Shtojcës 8 të DST.

Shenim: Referuar pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, ku parashikohet : “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

Argumentimi : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, si dhe referuar grafikut të punimeve të hartuar nga projekt preventivuesi. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore si dhe përvojën e nevojshme për ekzekutimin e kontratës objekt prokurimit. Bazuar në numrin e punëtorëve se kerkuar dhe numerin e inxhinierëve del në përfundimin një nr prej 27 punonjësish të kerkuar për këtë procedurë prokurimi.

NR	NR. AN.	EMERTIMI I PUNIMEVE	NJESIA	SASIA	O.P./NJ ESI	TOTALI I OREVE TE PUNES
A- PUNIME PER LIRIMIN DHE PASTRIMIN E SHESHIT						
1	3.101/a	Germim dheu me ekskavator goma 0.50 m ³ , ne kanale gjeresi deri 2 m, toke zak, kat III, me shkarkim ne mjet	m ³	2,800	0.06	168
2	3.158/5a	Transport dheu me auto deri 5.0 km	m ³	1,400	0.087	121.8
3	An.1 64/1 b	Mbushje me cakell e gur gurore ne trupin e rruges, perhapur e ngjeshur me makineri	m ³	1,400	0.82	1148
4	3.211	Shtrese çakelli mbeturine kave t=20cm, perhapur e ngjeshur makineri	m ²	4000	0.075	300
5	3.212/b	Shtrese stabilizant t=10 cm	m ²	4000	0.102	408
6	3.222/1	Shtrese binderi me granil gur kave, 5 cm, me makineri	m ²	4000	0.15	600
7	3.241/1	Shtrese asfaltbetoni me granil guri kave, 3cm, me makineri	m ²	4000	0.105	420
		TOTALI				3166
E- PUNIME TE KULLIMIT TE UJERAVE SIPERFAQESORE						

1	3.101/a	Germim dheu me ekskavator goma 0.50 m ³ , ne kanale gjeresi deri 2 m, toke zak, kat III, me shkarkim ne mjet	m ³	450	0.06	27
2	An.9	Mbushje me zhavorr	m ³	150	0.66	99
3	An.22	Pusete b/a shiu 40 x 40 cm, h = 100 cm, me kapak zgare hekuri	cope	12	13.3	159.6
4	An.	F.V tuba te brinjezuar HDPE SN8 d=200 mm	ml	180	0.23	41.4
		TOTALI				327
B- PUNIME PER NDERTIMIN E RRUGES						
1	3.245	Ndertim mure Struktura Monolite Betoni C25/30	m ³	47	14.3	672.1
2	3.288	Struktura monolite betoni C 1 2/15	m ³	55	14.6	803
3	3.288	F V hekur betoni I zakonshem 0 > 12mm/Steel bars B > 12mm	ton	1.30	35.15	45.695
4	An-8	Mbushje me cakell pas mureve	m ³	50	0.67	33.5
5	An-55	F.V tub drenazhi Ø150 mm	m	350	0.13	45.5
						1599.79
						5
D-PUNIME TROTUARI DHE PER HAPESIRAT						
1	3.620	Trotuar, me 6 cm beton, me pllaka	m ²	400	0.5	200
2	3.212/d	Shtrese stabilizant t=20 cm	m ²	400	0.21	84
3	3.617/1	F V bordura betoni 15x30 cm	M	400	0.25	100
4	3.243	Struktura monolite betoni C 16/20 (per kuneten dhe bordurat)	m ³	25	12.6	315
5	An-3.27	Mbushje dhe pasurim me dhe vegjetal	m ³	18	1.5	27
6	An 164	F.V. Fidane Peme dekorative	cope	20	1	20
						746
E-NDERTIMI I ARGJINATURES						
1	3.101/a	Germim dheu me ekskavator zingjir 0.5 m ³ , ne kanale gjeresi deri 2 m, toke zak, kategoria IV, me shk ne toke	m ³	700	0.065	45.5
2	An 1	Mbushje e ngjeshje me dhe' e zhavor e argjinatures me shtresa cdo 20-30cm (analize per 1m3)	m ³	150	0.65	97.5
3	3.161	Rrafshim skarpate ne germim, ekskavator 1 m ³	m ²	4000	0.02	80
4	An 2	F+v. tombino b/arme d=150cm	ml	20	8.4	168
5	3.244	Beton C16/20 per tombinon, muret e shtresat, kalimi tubo 150cm		18	11.2	201.6
6	3.97/b	Germim dheu me eskavator me zinxhir 0.25 m ³ per mbrojtjen	m ³	300	0.3	90
7	An.5	Mbushje + ngjeshje me dhe' e zhavor pas gabionave	m ³	200	0.48	96
8	3.332	Gabiona me rrjete teli te zinguar, gure kave 1x1x1.5 m	m ³	140	6.2	868
9	3.331	Gabiona me rrjete teli te Zinguar e gure kave 1x1x1 m	m ³	140	5.8	812
10	3.240	Struktura monolite betoni C 12/'15 mbi Gabion	m ³	16	9.73	155.68
						2614.28
G-SINJALIZIMET DHE SIGURIA RRUGORE						
1	An 48	Tabele katrore normal me A=60	Cope	2	4	8
2	An 100	Tabele rrethi "detyrim" normal me D = 60	Cope	2	4	8

3	An 103	Tabele rrethi "ndalim" normal me D = 60	Cope	2	4	8
4	An 121	Pervijues special pengesash per ishuj trafiku dhe ndares trafiku	Cope	2	1.5	3
5	An 142	Boje bikomponente (sprajt) per kalimtare	cope	20	0.4	8
6	An 64	Sinjalet e drejtimit urban HxL normal 25x125	Cope	2	0.5	1
7	An 122	Vijezim shirita gjatesor dhe anesor me gjeresi 12 cm. Bikomponente (sprajt)	cope	300	0.1	30
						66
		Totali i oreve te punes				8519
		Totali I diteve te punes (Totali 1 oreve te punes/8 ore)				1065
		Dite pune gjithsej (Afati 2 muaj x 22 dite pune/muaj)				44
		Numri 1 punonjesve (Manovrator+shofer+ punonjes te kualifikuar + puntore)				21
		Stafi drejtues (inxhiniera +teknik ndertimi+Pergjegjes per sigurine)				6
		Numri total I puntoreve				27

2.3.7 Operatorët ekonomikë duhet të disponojnë mjetet dhe pajisjet e nevojshme teknike për realizimin e kontratës :

1	Kamion vetë shkarkues , kapaciteti mbajtës jo më pak 12-18 ton	3 cope	Pronësi ose me qera
2	Kamiocina kapaciteti	3 copë	Pronësi ose me qera
3	Eskavator me zinxhir krahgjate jo me pak se 15 m	1 copë	Pronësi ose me qera
4	Eskavator me gonna	1 cope	Pronësi ose me qera
5	Fadroma me goma	1 cope	Pronësi ose me qera
6	Buldozier	1 cope	Pronësi ose me qera
7	Autovine mbi 10 ton	1 cope	Pronësi ose me qera
8	Autobetoniere	2 cope	Pronësi ose me qera
9	RTV - Trasportier per mjete te renda	1 cope	Pronësi ose me qera
10	Autobitumatrice	1 cope	Pronësi ose me qera
11	Asfaltshtruese	1 cope	Pronësi ose me qera
12	Rrul 15 ton	1 cope	Pronësi ose me qera
13	Rrul 8-12 ton	2 cope	Pronësi ose me qera
15	Depozite uji	1 copë	Pronësi ose me qera
16	Pompe betoni	1 cope	Pronësi ose me qera
17	Matrapik	1 copë	Pronësi ose me qera
18	Makineri vijezimi	1 copë	Pronësi ose me qera
19	Vibrator betoni	2 copë	Pronësi ose me qera
20	Gjeneratore	2 copë	Pronësi ose me qera
21	Saldatrice	2 copë	Pronësi ose me qera

Të paraqiten mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit si më poshtë :

- Kokore minimumi 27 copë
- Këpucë pune 27 copë

- Fikëse zjarri të lëvizshme me kapacitet minimumi 10 copë
- Prozhektorë ndricimi natën minimumi 5 copë
- Komplet i ndihmës së shpejtë minimumi 10 copë
- Jelek pune 27 cope
- Doreza pune 27 cope
- Tabela paralajmëruese për siguri në objekt inimumi 27 copë

Është e mjaftueshme paraqitja e deklaratës, sipas shtojcës nr.8:

Ofertuesi për makineritë, të cilat janë në pronësi ose me qera, duhet të paraqesë, dokumentacionin e meposhtëm :

Për mjetet që janë në pronesi, duhet të paraqitet :

- a) dokumenti që vërteton pronësinë (çertifikatën e pronësisë së mjetit rrugor);
- b) dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi);
- c) çertifikata e vlefshme e kontrollit teknik (SGS);
- d) siguracioni (polica e sigurimit) i vlefshëm i mjetit;
- e) foto të mjetit ku të evidentohen qartësisht të dhënat specifike të tij.

Kur janë me qera, duhet të paraqitet :

- a) kontrata e qerasë;
- b) dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi);
- c) çertifikata e vlefshme e kontrollit teknik (SGS);
- d) siguracioni (polica e sigurimit) i vlefshëm i mjetit;
- e) foto ku të evidentohen qartësisht të dhënat specifike të tij.

Për mjetet apo pajisjet e tjera që nuk pajisen me leje qarkullimi, ofertuesi duhet të paraqesë kontratë noteriale të blerjes ose fatura tatimore të blerjes ose dokument zhdoganimi të mjetit dhe foto të tyre.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Mjetet e kërkuara janë vendosur në proporcion me zërat dhe volumet e punimeve dhe afatin e përlllogaritur për realizimin e kontratës objekt prokurimi.

Numri dhe lloji i makinerive në pronësi / qira janë vlerësuar si të nevojshme në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës, duke i u referuar punimeve sipas standardeve, grafikut, kohëzgjatjes së punimeve dhe specifikimeve teknike të projekt zbatimit. Për të zbatuar kontratën, operatorët ekonomikë duhet të përmbushin kapacitetet teknike të pajisjeve dhe asetëve të tjera fizike, për këtë janë përcaktuar edhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin ofertuesit. Nëpërmjet kapaciteteve teknike operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë aftësinë dhe kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asetet e tjera fizike, aftësitë organizative. Mjetet e kërkuara është i lidhur ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës sipas specifikave të kërkuara.

Argumentimi për dokumentacionin e kërkuar për mjetet:

“ Kodi rrugor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar , neni 92 parashikon shprehimisht se “Automjetet, motomjetet dhe rimorkiot për të qarkulluar duhet të jenë të pajisura me një leje qarkullimi dhe të jenë të regjistruara pranë degëve përkatëse të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor.” “ Kodi rrugor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar , neni 79/3 parashikon shprehimisht se “Të gjitha mjetet që qarkullojnë dhe hyjnë në territorin e Republikës së Shqipërisë, janë të detyruara të kalojnë në kontrollin teknik vjetor dhe atë periodik” Ligji nr. 10076, datë 12.2.2009 “ Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit” neni 4 parashikon shprehimisht se: “Pronari i çdo mjeti transporti, përpara përdorimit të mjetit, është i detyruar të lidhë një kontratë sigurimi, sipas pikës 1 të nenit 2 të këtij ligji, si dhe të sigurojë rinovimin e saj për aq kohë sa mjeti i transportit do të mbetet në qarkullim.” Ligji nr.8308 datë 18.03.1998 “ Për transportet rrugore” neni 5 parashikon shprehimisht se : “Veprimtaria e transportit rrugor për udhëtarë dhe mallra për të tretë dhe me qira, kryhet mbi bazën e licencës.”

(Shënim: përcaktoni aktin ligjor apo nënligjor, në bazë të të cilit është bërë përllogaritja teknike e numrit të punonjësve dhe mjetet/makineritë/pajisjet e nevojshme për zbatimin e kontratës)

N r.	Mjeie/pajisje teknihe	Sasia	Punimet:
1	Kamion vete shkarkues , kapaciteti mbajtes jo me pak 12-18 ton	3 cope	Nevojiten per largimin e materialeve qe dalin nga procesi i germimeve
2	Kamiocina	3 copë	Karniocinat nevojiten per transportin e materialeve hidraulike, paisjeve, puntorise etj.
3	Eskavator me zinxhir kiahgjate jo me pak se 15	1 copë	Eshte i nevojshem per germimet qe do realizoheo per ndertimin e argjinatures
4	Eskavator me goma	1 cope	Eshte i nevojshem per germimet qe do realizohen per kullimin e ujrave siperfaqesore
5	Fadroma me goma	1 cope	Per germimet e ndyshme
6	Buldozier	1 cope	Per mbushje e ngjeshje me dhe e zhavor me shtresa cdo 20-30cm ne argjinature
7	Autovinc mbi 10 ton	1 cope	Eshte i nevojshem per ngritjen e peshave te ndryshme ne objekt si F*v. tomb ino b/arme d=I 50cm, etj..
8	Autobetoniere	2 cope	Per betonimet
9	RTV - Trasportier per mjete te renda	1 cope	Per levizjen e makinerive te renda
10	Autobitumatrice	1 cope	Per sperkatjen me praimer te sheshit gjate procesit te asfaltimit
11	Asfaltoshtruese	1 cope	Per realizimin e asfaltimit
12	Rrul 15 ton	1 cope	Per ngjeshjen e shtresese se cakullit me t-20 cm

13	Rrul 8-12 ton	2 cope	Per ngjeshjen e stabilizantit mo t' 10cm dhe shtresave te asfaltit
15	Depozite uji	1 copë	Per te siguruar fumizimin me uje per betonieret etj
16	Pompe betoni	1 cope	Per betonet
17	Matrapik	1 copë	Per prishjet e nevojshme
18	Makineri vijezi	1 copë	Per realizimin e vijezi
19	Vibrator betoni	2 copë	Per vibrimin e betonit gjate proceseve te betonimit
20	Gjeneratore	2 copë	Per sigurimin e energjise
21	Saldatrice	2 copë	Per saldimet qe do dalin gjate punes

2.4. Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.4.1 Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se e zhvillojnë aktivitetin e tij në fushën objekt prokurimi në përputhje me standardet e menaxhimit të cilësisë si dhe të shëndetit e sigurisë në punë. Për këtë duhet të paraqesin certifikatat e mëposhtme:

- Certifikatë **ISO 9001:2015** mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë” ose ekuivalente lëshuar nga institucionet zyrtare të akredituara për këtë qëllim;
- Certifikatë **ISO 45001 - 2018** mbi “Sistemin e Menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurisë në punë” ose ekuivalente lëshuar nga institucionet zyrtare të akredituar për këtë qëllim;
- Certifikatë **ISO 14001:2015** mbi “Sistemet e menaxhimit të mjedisit”, ose ekuivalente lëshuar nga institucionet zyrtare të akredituara për këtë qëllim;

Çertifikatat sa më sipër duhet të paraqiten origjinale ose kopje të noterizuara, të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Çertifikatat duhet të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zërave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes.

Argumentimi : Kjo kërkesë është vendosur për të vërtetuar pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, standardet për shëndetin dhe sigurinë në punë. Ky kriter është përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 44, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se plotësojnë standartet e kërkuara të cilësisë dhe standardet për shëndetin dhe sigurinë në punë dhe standartet e menaxhimit të mjedisit

(Shënim: Autoriteti/enti kontraktor, në varësi të natyrës së objektit të prokurimit, mund të përcaktojë kriteret e tjera të vecanta, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës, duke argumentuar teknikisht dhe ligjërishit çdo kriter, duke përcaktuar, sipas rastit, aktin ligjor/nënligjor që parashikon domosdoshmërinë e kriterit në fjalë).

Argumentimi i specifikimeve teknike

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose

Argumentimi:Specifikimet teknike jane hartuar nga projektuesi dhe shprehin qarte kerkesat e autoritetit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe materialeve, bazuar në VKM-në Nr.629, DATË 15.07.2015 ”PËR MIRATIMIN E MANUALEVE TEKNIKE TË ÇMIMEVE TË PUNIMEVE TË NDËRTIMIT DHE TË ANALIZAVE TEKNIKE TË TYRE (Ndryshuar me VKM nr. 631, datë 26.10.2018).

Në specifikimet teknike, ne rastet kur është përmendur një markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, do te pranohen ose ekuivalente”.

NJËSIA E PROKURIMIT